

Data 15.02.2023

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-PUNË

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROKURIMIT:

“Rehabilitimi i zonës që preket nga zgjerimi territorial i varrezave të qytetit të Durrësit”

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Kodi
CPV: 45112714-3 - Punime në natyrë për varreza**

VLERA E FONDIT LIMIT: 240’000’000 (dyqind e dyzetë milion) lekë pa TVSH.

Afati i realizimit të punimeve është 720 ditë

Garancia per mbulimin te difekteve ,që mund te lindin gjatë shfrytëzimit të objektit , nga ana e firmës të jetë 2 vjet .

Argumentim:

**MBI PËRGATITJEN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE PËRLLOGARITJEN E VLERËS
LIMIT TË KONTRATËS**

Në zbatim të urdhërit të grupit te Specifikimeve nr. 68 datë 05.01.2023 nr.13 të Titullarit të Autoritetit Kontraktor, “Mbi Përgatitjen e Specifikimeve Teknike dhe Përllogaritjen e Vlerës Limit per objektin e mësipërm, të planifikuar për tu kryer në programet e investimeve. Grupi i specifikimeve teknike, pasi u njoh me objektin e prokurimit:

1. Dokumenteve sipas VKB Nr.150, datë 22.12.2022 “Per miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2023-2025 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë Durrës për vitin 2023 të miratuara nga Këshilli Bashkiak”.
2. Shqyrtoi dokumentat e mësipërme dhe programoi punën për grumbullimin e informacionit, lidhur me projektin, preventivin dhe specifikimet teknike të punimeve, te hartuar nga: Grupi i Specifikimeve Teknike pjesë e UKD.

PËRCAKTIMI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE :

Në përcaktimin e specifikimeve teknike, grupi i punës u mbështet në:

Specifikimet tenike të hartuar nga Drejtoria e Projekteve dhe Infrastruktures, objekt i këtij prokurimi.

Specifikimet Teknike të Përcaktuara në këto Dokumente janë në përputhje të plotë me kërkesat e Ligjit Nr. 162 , datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”, dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

PËRLLOGARITJA E VLERËS LIMIT TE KONTRATËS

Për përllogaritjen e vlerës limit të kontratës, Mbështetur në Ligjit nr.162 datë 23.12.2020 dhe VKM, Nr 285, datë 19.05.2021, “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, neni 76, sipas të cilit:

1. Në përllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti/enti kontraktor duhet t’i referohet një ose më shumë alternativave të renditura, si më poshtë vijon:

a) çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj.); ose/dhe

b) studimit të tregut, bazuar në mesataren e çmimeve të marra nga ky studim; ose/dhe

c) çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore; ose/dhe

ç) çmimet ndërkombëtare të shpallura publikisht.

Autoriteti/enti kontraktor mund t’i referohet një ose me shumë alternativave të mësipërme në përllogaritjen e vlerës limit të kontratës, me qëllim që ajo të jetë një vlerë reale për kushtet e tregut dhe njëkohësisht të krijojë mundësinë e pjesëmarrjes së sa më shumë operatorëve ekonomikë.

Afati i realizimit të punimeve është 720 ditë.

Garancia per mbulimin e difekteve, që mund të lindin gjatë shfrytëzimit të objektit , nga ana e firmës të jetë 2 vjet.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, neni 2, pika 2/c dhe neni 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Durrës ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Sipas specifikimeve bashkangjitur të hartuara, vendosur dhe perlllogaritur nga struktura të posacme të specializuara, e konkretisht nga: “Grupi i punes për hartimin e specifikimeve teknike dhe perlllogaritjen e fondit limit”, mbështetur në Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit janë standarte dhe nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3

b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas Shtojcës 8

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenin 39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”si dhe nenit

(Shënim: përcaktoni **nëse është rasti**, aktin konkret ligjor ose nënligjor që parashikon plotësimin e ndonjë kërkesë specifike për ushtrimin e veprimtarisë profesionale që lidhet me objektin e prokurimit apo nevojën që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë, kur një gjë e tillë është e detyrueshme nga legjislacioni përkatës).

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2019, 2020, 2021 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 240’000’000 lekë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Vlera e xhiros së kërkuar është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj. Vlera e xhiros është vendosur që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Kerkesa e mesiperme eshte bazuar ne vleren e fondit limit te kesaj procedure,si dhe mbeshtetet ne ne nenin 77, pika 3, e LPP, VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,neni 43,b

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ne Ligjin 9920 date 19.05.2008, Per Procedurat Tatimore ,neni 64 Deklarata Tatimore

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2019, 2020, 2021 të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve ne perputhje me Ligjin nr.10091, datë 05.03.2009 Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar, i ndryshuar. Kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancin/et e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit..

(Shënim: ky kriter vendoset vetëm në rastet kur vlerësohet nga autoriteti/enti kontraktor)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në Ligjin nr. 9920 date 19.05.2008 ”Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe aktet nenligjore ne zbatim te tij.

Kërkesa për paraqitjen e bilanceve është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës

2.2.3 Një dokument që vërteton se (subjekti juaj) i ka plotësuar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, për vitin 2022 referuar ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”i ndryshuar , si dhe sipas Vendimit të Këshillit Bashkiak përkatës ku subjekti ushtron aktivitetin, lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë këtë dokument).

Ky kriter përmbushet nepermjet paraqitjes se Formularit permbledhes te Vetedeklarimit sipas shtojces 8 ne DST.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, e LPP, si dhe të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Kjo kerkese bazohet ne Ligjin nr.9632,date 30.10.2006 ,Per sistemin e taksave vendore i ndryshuar, neni 5, pika c, sipas afateve te miratuara te kryerjes se pagesave te percaktuara nga cdo njesi e qeverisjes vendore

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

- a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 120’000’000 Lekë, të realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose
- b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se 480’000’000 lekë. Plotësimi i njërës prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

Vërtetime të lëshuara nga një autoritet/ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve. të shoqëruara me formular vlerësimi sipas shtojcës 9.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, kërkohet: ,Vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Referuar fondit limit sipas nenin 39, pika 5 "Kërkesa të vecanta për kontratat për punë publike", të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"

Aftësitë teknike dhe profesionale te tjerat si me poshtë janë hartuar, vendosur dhe perlllogaritur nga struktura të posacme të specializuara, e konkretisht nga: "Grupi i punes për hartimin e specifikimeve teknike dhe perlllogaritjen e fondit limit", mbështetur në Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik":

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë , e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

- NP. 1-B, Punime gërmimi në tokë;
- NP. 4-D, Rugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvaj, metro, pista aeroportuale;
- NP. 5-B, Punime nëntokësore, ura dhe vepra arti;
- NP. 7-B, Ujësjiellësa, gazsjellësa, vajsjiellësa, vepra kullimi e vaditje;
- NP. 12-A, Punime të inxhinierisë së mjedisit;
- NS. 1-A, Punime për prishjen e ndërtimeve;
- NS. 4-A, Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtuese
- NS. 8-A, Ndërtime parafabrikat beton arme, struktura metalike dhe druri;
- N.S. 18-A Punime topogjeodezike;

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", si dhe Vendim nr.42, datë 16.1.2008 "Për miratimin e rregullores, për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi", i ndryshuar.

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

KATEGORIA E KËRKUAR	PERSHKRIMI I KATEGORISË SIPAS LEGJISLACIONIT TË FUSHËS	ZËRAT E PUNIMEVE QË PARASHIKOHEN TË KRYHEN NË PREVENTIV, QË PËRFSHIHEN NË KATEGORINË PËRKATËSE	NIVELI I KLASIFIKI MIT I KËRKUAR PËR KATEGORI NË RESPEKTIV E	VLERA E PUNIMEVE QË PARASHIKOHEN TË KRYHEN NË PREVENTIV, QË PËRFSHIHEN NË KATEGORINË PËRKATËSE
NP. 1-B	<p>Punime gërmimi në tokë;</p> <p>(Konsiderohen gërmimet, sistemimet dhe ndryshimet në volum të tokës, të realizuara me çfarëdo lloj mjeti, pavarësisht nga natyra e terrenit që do të gërmohet ose sistemohet vegjetale, argjilore, ranore, zhavorrishte ose shkëmbore.)</p>	<p>A-2. Punime per ndertimin e Rrugeve te Brendshme</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Gërmim dheu me ekskavator goma 0.15 m³, toke zak, kategoria III, me shkarkim ne toke 2. Gërmim me krahe, toke e zakonshme 3. Ndertim kasonete ne toke mesatare 4. Transport dheu me auto deri 5.0 km <p>A-3. Punime ne Bordura, Vepra Arti, KUSH, Mure Pritese, Mbajtese, Rrethues etj</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Gërmim dheu me ekskavator goma 0.15 m³, toke zak, kategoria III, me shkarkim ne toke 2. Gërmim me krahe, toke e zakonshme 3. Transport dheu me auto deri 5.0 km <p>A-4. Punime per linje ujesjellesi e cezma publike</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Gërmim dheu me ekskavator goma 0.15 m³, toke zak, kategoria III, me shkarkim ne toke 2. Gërmim me krahe, toke 	B, 21-50 milionë lekë	Tot. 42,683,145 lekë

		<p>e zakonshme</p> <p>3. Transport dheu me auto deri 5.0 km</p> <p>A-5. Punime per linjat dhe bazamentet e ndricimit rrugor</p> <p>1. Germim dheu me ekskavator goma 0.15 m³, toke zak, kategoria III, me shkarkim ne toke</p> <p>2. Germim me krahe, toke e zakonshme</p> <p>3. Transport dheu me auto deri 5.0 km</p>		
NP. 4-D	<p>Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvaj, metro, pista aeroportuale;</p> <p>(Përfshin në mënyrë të thjeshtuar rrugët, pavarësisht nga shkalla e tyre e rëndësisë, ..., parkimet, punime të mureve mbajtëse, ..sheshet të realizuara me materiale ..., natyrale dhe artificiale, urat, si dhe komplekse karakteristikash teknike, në hekur, betonarme të thjeshtë dhe të paranderur, parafabrikat ose të prodhuar në objekt.)</p>	<p>A-2. Punime per ndertimin e Rrugeve te Brendshme</p> <p>1. Ndertim kasonete ne toke mesatare</p> <p>2. Cilindrim kasonete me rul</p> <p>3. Mbushje me cakell e gur gurore ne trupin e rruges, perhapur e ngjeshur me makineri</p> <p>4. Shtrese çakelli mbeturine kave t=20cm, perhapur e ngjeshur makineri</p> <p>5. Shtrese stabilizanti 15cm</p> <p>6. F.V. beton C20/25 per shtrese rruge</p> <p>7. Perpunim siperfaqesor per rritjen e aderences dhe jetgjatesise i shtreses se betonit, perfshi 1.6 kg fibra polipropilene dhe 2 kg rere kuarci</p> <p>8. F V hekur betoni i zakonshem Ø 6 ~ 10mm</p> <p>9. Ndertim rruge te brendshme me pllake betoni te parapergatitur t=6 cm beton</p> <p>A-3. Punime ne Bordura,</p>	D, 101-2000 milionë lekë	Tot. 144,507,016 lekë

		<p>Vepra Arti, KUSH, Mure Pritese, Mbajtese, Rrethues etj</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. F V bordura betoni C 20/25 15x30 cm 2. F.V. Bordure betoni C 20/25 10x20cm 3. Bordura betoni C 20/25 6x20 cm 4. F.V. Kunete betoni e parafabrikuar C 20/25 ne rruget me pllake 5. F.V. Beton C25/30 per mure, rrethim, puseta, portale, riparime strukturash ekzistuese, etj 6. Mbushje me zhavorr mbi tuba, mbas strukturave, etj 		
NP. 5-B	<p>Punime nëntokësore, ura dhe vepra arti;</p> <p>(Konsiderohen., punime të mureve mbajtëse. Përfshin në mënyrë të thjeshtuar ... shpime, kalime nëntokësore...)</p>	<p>A-3. Punime ne Bordura, Vepra Arti, KUSH, Mure Pritese, Mbajtese, Rrethues etj</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. F.V. Beton C25/30 per mure, rrethim, puseta, portale, riparime strukturash ekzistuese, etj <p>A-4. Punime per linje ujesjellesi e cezma publike</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Mikrotunel D=50 mm, poshte rruges per kalimin e tubit te polietilenit PEHD+ rakorderi, per lidhjen e rrjetit te ri te ujesjellesit ne rrjetin ekzistues <p>A-6. Punime pastrimi / zevendesimi i tombinove ekzistuese, rikonstruksion e perforcim varreza ekzistuese, gjelberim e arredim</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Instalim tubi me carje per zevendesim kolektorësh ekzistues Ø (250 ÷ 600), (Pipe bursting) 	B, 21-50 milionë lekë	Tot. 36,196,392 lekë

NP. 7-B	Ujësjetllës, gazsjetllës, vajsjetllës, vepra kullimi e vaditje		B, 21-50 milionë lekë	
	<p>(...Përfshin në mënyrë të thjeshtuar, rrjetin shpërndarës..., furnizimi dhe vendosja në vepër e tubacioneve, shkarkimet ...)</p>	<p>A-3. Punime ne Bordura, Vepra Arti, KUSH, Mure Pritese, Mbajtese, Rrethues etj</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. F.V. Tuba te brinjezuar HDPE SN8 Dn=200 mm 2. F.V. Tuba te brinjezuar HDPE SN8 Dn=250 mm 3. F.V. Tuba te brinjezuar HDPE SN8 Dn=315 mm 4. F V tuba te brinjezuar HDPE SN8 Dn=400 mm 5. F V tuba te brinjezuar HDPE SN8 d=500 mm 6. F V tuba te brinjezuar HDPE SN8 d=600 mm 7. Pusete b/a shiu 40 x 40, h = 100 cm, me kapak gize 8. Puse kontrolli 1x1x1.5m <p>A-4. Punime per linje ujesjetllesi e cezma publike</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Mbushje me shtrese rere 2. Puse kontrolli 1x1x1.5m 3. F.V Tuba e rakorderi ujesjetllesi PE d=40mm, t = 4.5 mm, PN 20 4. F.V Tuba e rakorderi ujesjetllesi PE d=50mm, t = 5.6 mm, PN 20 5. F.V. saracineska celiku me flanaxha, Pn25 bar, φ50 6. F.V Valvul ajernxjerrese 4" Pn 25 7. F.V TEE EF 50 mm 8. F.V reduksion EF 50 x 40 mm 9. Lidhje me rrjetin e ujesjetllesit ekzitues 		<p>Tot. 27,789,475 lekë</p>

		10. F.V cezma publike 11. Mikrotunel D=50 mm, poshte rruges per kalimin e tubit te polietilenit PEHD+ rakorderi, per lidhjen e rrjetit te ri te ujesjellesit ne rrjetin ekzistues 12. Mbushje me zhavorr mbi tuba, mbas strukturave, etj		
NP. 12-A	Punime të inxhinierisë së mjedisit; (...Përfshin në mënyrë të thjeshtuar, procesin e riaftësimit natyror...dhe ripyllëzimeve të punimeve...rivegjetizimin e skarpateve rrugore...)	A-6. Punime pastrimi / zevendesimi i tobinove ekzistuese, rikonstruksion e perforcim varreza ekzistuese, gjelberim e arredim 1. F.V. Fidane Shkurre dekorative, (oleander, fotinje, etj) 2. F.V. bredha / pisha 3. F.V. Fidane akacie ne skarpata 4. F.V. Fidane bime kacavjerrese ne skarpata	A, 0-20 milionë lekë	Tot. 1,727,660 lekë
NS. 1-A	Punime për prishjen e ndërtimeve (Konsiderohet ...prishjeve në përgjithësi përfshi edhe grumbullimin e mbeturinave,...).	A-1. Punime Prishjeje dhe Çmontimi 1. Prishje mure, kanale, puseta e struktura betoni ekzistuese 2. Prishje shtresa betoni	A, 0-20 milionë lekë	Tot. 4,114,948 lekë
NS. 4-A	Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtuese (Konsiderohet vendosja në vepër.. të dysHEMEVE të tipeve të ndryshme dhe me materiale të ndryshme)	A-2. Punime per ndertimin e Rrugeve te Brendshme 1. Perpunim siperfaqesor per rritjen e aderences dhe jetgjatesise i shtreses se betonit, perfshi 1.6 kg fibra polipropileni dhe 2 kg rere kuarci	A, 0-20 milionë lekë	Tot. 9,363,050 lekë
NS. 8-A	Ndërtime parafabrikat beton arme, struktura metalike dhe druri; (Përfshin prodhimin në rrugë industriale dhe montimin në vepër të strukturave	A-2. Punime per ndertimin e Rrugeve te Brendshme 1. Ndertim rruge te brendshme me pllake betoni te parapergatitur	A, 0-20 milionë lekë	Tot. 17,203,313 lekë

	parafabrikate prej betoni të armuar, normal ...)	<p>t=6 cm beton</p> <p>A-3. Punime ne Bordura, Vepra Arti, KUSH, Mure Pritese, Mbajtese, Rrethues etj</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. F V bordura betoni C 20/25 15x30 cm 2. F.V. Bordure betoni C 20/25 10x20cm 3. Bordura betoni C 20/25 6x20 cm 4. F.V. Kunete betoni e parafabrikuar C 20/25 ne rruget me pllake 5. Pusete b/a shiu 40 x 40, h = 100 cm, me kapak gize 6. Puse kontrolli 1x1x1.5m 7. Mur me blloqe betoni t=20cm deri 3m me llaç perzier M 15 		
N.S.18-A	Punime topogjeodezike; (Konsiderohet zbatimi... punime topogjeodezike në objekte inxhinierike)	<p>Kërkuar për arsye të zbatimit të punimeve te piketimit per realizimin e objektit ne teresi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Piketmi i punimeve te germimit. • Piketim i punimeve te ndertimit te mureve, e veprave te tjera mbajtes, pritese rrethuese. • Piketim i punimeve te ndertimit rrjeteve te largimit te ujerave siperfaqesore, • Piketim i punimeve te ndertimit shtresave rrugore. • Rilevim per dokumentim (Ass Build) te gjithë punimeve te kryera. 	A, 0-20 milionë lekë	

2.3.3. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë **personelin kryesor, drejtues teknik** në licencën e shoqërisë, si më poshtë:

➤ Inxhinier Ndërtimi	1(një)
➤ Inxhinier Gjeoteknik	1(një)
➤ Inxhinier Gjeoded	1(një)
➤ Inxhinier Hidroteknik	1(një)
➤ Inxhinier Mjedisi	1(një)

Për stafin e sipërcituar të te paraqitet diploma universitare, kontrata noteriale e punes, CV, libeza e punes, listëpagesat e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, sipas formularit E/Sig-25, për periudhën e kërkuar.

Ky kriter permbushet nepermjet paraqitjes se Formularit permbledhes te Vetedeklarimit sipas shtojces 8 ne DST.

2.3.4. Operatori ekonomik, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe **stafin mbështetës** (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë), si më poshtë:

- | | |
|-------------------------|---------|
| ➤ Inxhinier Ndërtimi | 1 (një) |
| ➤ Inxhinier Hidroteknik | 1 (një) |
| ➤ Inxhinier Mekanik | 1 (një) |
| ➤ Teknik Ndërtimi | 2 (dy) |
- Punonjes 1 (nje), pajisur me certifikatë per "Ekspert per ndihmen e pare dhe nderhyrjen ndaj emergjencave", shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, diplomë/certifikatë si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë të muajit të fundit.
 - Punonjes 1 (nje), pajisur me certifikatë per "Përgjegjes për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetin në punë" në përputhje me Ligjin Nr. 10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M Nr. 312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier", shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, diplome/certifikate si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë.
 - Mjek Epidemiolog 1 (nje) për mbikqyrjen e kryerjes së punimeve për përforcim e rikonstrukcion varreza ekzistuese në zonat me rrëshqitje aktive (në mbështetje të VKM Nr. 711, datë 29.10.2014 dhe Udhëzimit Nr. 4, datë 9.12.2015), shoqëruar

me kontratë individuale pune të vlefshme, diplomë mjeku /specializim, të figurojë në listëpagesat e shoqërisë.

- Puntorë të thjeshtë 15 (pesëmbëdhjetë)

Për stafin e sipërcituar të paraqitet dokumentacion që vërteton profesionin si: diplomat/liçenca e inxhinierëve, diplomat/dëshmi profesionale e teknikut të ndërtimit ose ekuivalenti i tij/saj, kontrata pune, listëpagesat e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, sipas formularit E/Sig-25, për periudhën e kërkuar.

Ndërsa për punëtorë të thjeshtë, të disponojë një vetëdeklarim nga shoqëria, ku listohen si punëtorë të thjeshtë.

Ky kriter permbushet nepermjet paraqitjes se Formularit permbledhes te Vetedeklarimit sipas shtojces 8 ne DST.

2.3.5. Operatori ekonomik duhet të disponojë **punonjës të specializuar/të kualifikuar**, si më poshtë:

- | | |
|----------------------------------|---------|
| ➤ Manovratorë për mjete ndërtimi | 2 (dy) |
| ➤ Drejtues Mjeti | 2 (dy) |
| ➤ Murator | 2 (dy) |
| ➤ Hekurkthyes | 2 (dy) |
| ➤ Saldator | 1 (nje) |
| ➤ Hidraulik | 1 (nje) |

Për stafin e sipërcituar të paraqitet dokumentacion që vërteton profesionin si: dëshmi profesionale të punonjësve ose ekuivalenti i tij/saj, kontrata pune, listëpagesat e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, sipas formularit E/Sig-25, për periudhën e kërkuar.

Ky kriter permbushet nepermjet paraqitjes se Formularit permbledhes te Vetedeklarimit sipas shtojces 8 ne DST.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:

Personeli i mësipërm kërkohet në bazë të vlerësimit të preventivit dhe të grafikut të punimeve.

Kriteri për stafin inxhinierik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të punimeve. Numri i stafit kryesor teknik si numri i inxhinierit të ndërtimit, gjeoteknik, gjeodet, hidroteknik, mjedisi, është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Drejtuesi i teknik është përgjegjës për ndërtimin në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës. Bazuar në parashikimet e mësipërme të legjislacionit për prokurimin publik, Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij **drejtues teknik** të cilët kanë një rol të rëndësishëm në mbarëvajtjen e punimeve pasi ata janë përgjegjës për zbatimin e objektit sipas projektit dhe në përputhje me kushtet teknike të zbatimit të tij.

Kërkesa specifike për Inxhinierët e kërkuar është përcaktuar në kuadër të analizës teknike që i është bërë Preventivit të Punimeve (nga ku përcaktohet qartazi dhe profili inxhinierik) si dhe në bashkerendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë. Duke marrë në konsideratë Projektin e zbatimit si dhe Preventivin e Punimeve rezulton se është e domosdoshme që çdo Ofertues të ketë pjesë të stafit kryesor të cilët në bashkëpunim me njëri tjetrin ,stafin mbështetës si dhe me fuqinë punëtore të shoqërisë do të realizojnë me sukses kontratën objekt prokurimi.

- Referuar në preventivin e Punimeve si dhe në bashkerendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas pikës **NP - 1, NP - 4, NS.1, NS. 4, NS.8**, është e nevojshme prezenca e **Inxhinierit të Ndërtimit**.
- Referuar në preventivin e Punimeve si dhe në bashkerendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas pikës **NP.5** është e nevojshme prezenca e një **Inxhinier Gjeoteknik /**, pasi çdo matje që do të bëhet në funksion të objektit të prokurimit kërkon domosdoshmërisht praninë e këtij Inxhinieri.
- Referuar në preventivin e Punimeve si dhe në bashkerendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas pikës **NS 18** është e nevojshme prezenca e një **Inxhinier Gjeodet/**, pasi çdo matje që do të bëhet në funksion të objektit të prokurimit kërkon domosdoshmërisht praninë e këtij Inxhinieri.
- Referuar në preventivin e Punimeve si dhe në bashkerendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas pikës **NP.7** është e nevojshme prezenca e një **Inxhinier Hidroteknik /**, pasi çdo matje që do të bëhet në funksion të objektit të prokurimit kërkon domosdoshmërisht praninë e këtij Inxhinieri.
- Referuar në preventivin e Punimeve si dhe në bashkerendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas pikës **NP.12** është e nevojshme prezenca e një

Inxhinier Mjedisi /, pasi çdo matje që do të bëhet në funksion të objektit të prokurimit kërkon domosdoshmërisht praninë e këtij Inxhinieri.

- Qëllimi i vendosjes së këtij kushti është i implementuar sipas dispozitave ligjore dhe shërben si një garanci që kontrata objekt prokurimi do të realizohet me sukses sipas Specifikimeve Teknike (të cilat do publikohen së bashku me Dokumentat e Tenderit) si dhe punimet do të kryhen brenda afatit kohor të parashikuar në Njoftimin e Kontratës. Sqarojmë se, të gjithë specialistët e kërkuar janë në përputhje të plotë me projekt-preventivin duke marrë në konsideratë volumet e punes që do të realizohen, si dhe kohëzgjatjen e tyre. Autoriteti Kontraktor domosdoshmërisht duhet të garantohet që këto punime do të kryhen nga persona të kualifikuar dhe me eksperiencë të mjaftueshme, për zbatimin e këtyre punimeve sipas standarteve të përcaktuara në specifikimet teknike. Për të vërtetuar kualifikimin e stafit teknik është kërkuar që të jenë të pajisur me diplomë/dëshmi përkatëse lëshuar nga institucione të akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik, (të vlefshme) lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik. Certifikimet/diplomat profesionale duhet të jenë të lëshuara nga institucione të licensuara nga organet përkatëse, mbështetur në Ligjin Nr. 15/2017 “PËR ARSIMIN DHE FORMIMIN PROFESIONAL NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË” Mbështetur në këtë legjislacion certifikimet profesionale ofrohen nga institucione të licensuara nga Ministria përkatëse nëpërmjet Agjencisë Kombëtare të Arsimit, Formimit Profesional. Certifikatat e këtyre specialisteve duhet të jenë të regjistruara në “rregjistrat profesionale” të AKAFP-se.
- **Inxhinieri i Ndërtimit** si stafi mbështetës është i nevojshëm për punimet për strukturat monolite prej betoni, për muret, pusetat, shtresat e betonit, instalimin e strukturave të parafabrikuara (pllaka, bordura, puseta, etj). Inxhinieri i ndërtimit do të jetë përgjegjës për kontrollin e cilësisë të të gjithë betonit dhe materialeve të tjera që do të përdoren në objekt. Materialet dhe mjeshteria e përdorur në punimet e betonit duhet të jetë e një cilësie sa më të lartë që të jetë e mundur, prandaj vetëm personel me eksperiencë dhe aftësi të plote në këto kategori punimesh do të punohet për punën që përfshin ky seksion specifikimesh. Janë kërkuar dy inxhiniera ndërtimi duke qenë se objekti ka shtrirje të gjata kohore përfshin edhe punime në varrezat ekzistuese edhe në parcelën e re.
- **Inxhinieri Hidroteknik** si stafi mbështetës është i nevojshëm për punimet e ndërtimit të linje ujesjellesi e çezma publike, punime për ndërtimin e rrjetit të largimit të ujarave të shiut, punime të pastrimit e zëvendësimit të rrjeteve të kolektoreve / tombinove ekzistuese, si dhe gjithë punimet e tjera me karakter hidroteknik. Janë kërkuar dy inxhiniera duke qenë se objekti përfshin edhe punime në varrezat ekzistuese edhe në parcelën e re, dhe të dyja kanë punime të konsiderueshme me karakter hidroteknik.
- **Inxhinieri Mekanik** si stafi mbështetës është i nevojshëm për prodhimin dhe instalimin e konstruksioneve metalike, të rrethimit që do të bëhet në parcelën e re, si dhe rrethimit të

nje pjese te varrezave ekzituese. Per kontrollin e instalimeve te rakorderive te pajisjeve metalike ne kapitullin e furnizimit me uje si dhe per monitorimin dhe mirembajtjen e mjeteve te punes, sinjalistikes, etj...

- **Tekniku i Ndertimit** eshte i nevojshem per organizimin e grupeve te punes e makinerive ne kantier per rritjen e eficenses dhe zbatimin e punimeve sipas afatit kohor te kerkuar nga investitori. Ai lexon dhe kontrollon zbatimin e projektit në përputhje me kushtet teknike të zbatimit dhe informon inxhinierin për ecurinë e puneës në kantier, duke koordinuar punen ne fronte të ndryshme. Jane kerkuar dy duke qene se objekti ka shume procese ndertimore ku perfshin edhe punime ne varrezat ekzituese edhe ne parcelen e r
- **Punonjës i pajisur me certifikate për ndihmen e pare dhe nderhyrjen ndaj emergjencave** është i nevojshëm për ndihmen e pare dhe nderhyrjen ndaj emergjencave, qe mund te paraqiten gjate realizimit te punimeve.
- **Punonjës i pajisur me certifikatë për "Përgjegjes për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetin në punë"** është i nevojshëm per te permbushur kerkesat e sigurise dhe shendetit ne pune në përputhje me Ligjin Nr. 10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M Nr. 312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier".
- **Mjek Epidemiolog** është i nevojshëm për per mbikqyrjen e kryerjes se punimeve per perforcim e rikonstruksion varreza ekzituese ne zonat me rreshqitje aktive (ne mbeshtetje te VKM Nr. 711, datë 29.10.2014 dhe Udhezimit Nr. 4, datë 9.12.2015), punime te cilat jane parashikuar edhe ne preventivin e punimeve. Eshte kerkuar mjeke duke qene se objekti perfshin rikonstruksionin e gjithe rrugeve te varrezave ekzituese. Ne keto rruge jane evidentuar varreza te ndertuara ne skarpatet e ketyre rrugeve dhe punimet ne keto akse duhet te kryhen nen mbikqyrjen e plote te mjekteve epidemiolog per te eliminuar cdo impakt negativ ne keto varreza dhe ne permbushje te Udhezimit Nr. 4, datë 9.12.2015, ku do te jete e nevojshme te nderhyhet per stabilizimin e rikonstruksionin e tyre.
- **Manovratorët 2 (dy)** janë të nevojshëm për drejtimin e mjeteve të rënda, duke qene se behet fjale per punime brenda varrezave ekzituese, dhe demtimi i tyre do te ishte mjaft sensitiv realizimi punimeve sipas projekti eshte tejet i rëndesishem, çka e ben te domosdoshem perdorimin e mjeteve te germimit (eskavatora, traktora), ngjeshjes (rrula) nga personel i kualifikuar. Janë kërkuar dy manovrator duke ju referuar grafikut te punimeve dhe numrit te mjeteve qe do alternohen per realizimin e proceseve te punes .
- **Drejtuësi i mjetit 2 (dy)** është i nevojshëm për drejtimin e automjeteve, duke qene se behet fjale per punime brenda varrezave ekzituese, dhe demtimi i tyre do te ishte mjaft sensitiv realizimi punimeve sipas projekti eshte tejet i rëndesishem, cka e ben te domosdoshem perdorimin e automjeteve si kamion, kamioncinë, autobetoniere, automjet teknologjik i pajisur

me sisteme kamerash, me automjet teknologjik i pajisur me pompe pastrimi, etj nga personel i kualifikuar. Janë kërkuar dy drejtuesi i mjetit duke ju referuar grafikut te punimeve dhe numrit te mjeteve qe do alternohen per realizimin e proceseve te punes .

- **Murator 2 (dy)** janë të nevojshëm për punime ndertimi sipas zerave te preventivit: (Ndertim rruge te brendshme me pllake betoni te parapergatitur t=6 cm beton, Puse kontrolli 1x1x1.5m, Mur me blloqe betoni t=20cm deri 3m me llaç perzier M 15, etj...). Janë kërkuar dy muratore duke ju referuar grafikut te punimeve per realizimin e proceseve te punes .
- **Hekurkthyes 2 (dy)** janë të nevojshëm për punime ndertimi sipas zerave te preventivit: (FV hekur betoni i zakonshem Ø 6 ~ 10mm, etj...). Janë kërkuar dy hekurkthyes duke ju referuar grafikut te punimeve per realizimin e proceseve te punes .
- **Saldator 1 (nje)** është i nevojshëm për punime ndertimi sipas zerave te preventivit: (F.V. Kangjella Dekorative + lyerje me dy dyar antiruxhio) Janë kërkuar nje saldator duke ju referuar grafikut te punimeve per realizimin e proceseve te punes .
- **Hidraulik 1 (nje)** është i nevojshëm për punime ndertimi sipas zerave te preventivit: (Punime per linje ujesjellesi e cezma publike). Është kërkuar nje hidraulik duke ju referuar grafikut te punimeve per realizimin e proceseve te punes .
- **Puntorë te thjeshte 15**(pesëmbëdhjetë) janë të nevojshëm për punime ndertimi sipas proceseve te punes ne preventivin e punimeve.
-

2.3.6 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej **minimalisht 38 persona**, në listpagesa sipas formularëve standart për sigurimet, **të siguruar ne listpagesat e tre muajve te fundit** te shoqerise nga momenti i hapjes së ofertës. Dokumenta të konfirmuara nga institucioni përkatës sipas legjisllacionit në fuqi (*nëpërmjet formës elektronike*). Lidhur me personelin e kerkuar, Ofertuesi duhet te paraqesë:

Vërtetim nga Administrata Tatimore, si edhe listëpagesat e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, sipas formularit E/SIG-25, për periudhën e kërkuar

Ky kriter përmbushen nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST

Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej **minimalisht __38__ persona**

Argumentimi: Autoriteti Kontraktor këtë kriter e ka bazuar në nenin 77, pika 4 të Ligjit nr.162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” në të cilin thuhet: “Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës”. Numri i punonjësve është përcaktuar bazuar në afatin, orët e punës dhe pagën minimale te lejuar, që duhen për të përmbushur zbatimin e kontratës. Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë me kohështrirje tre muajt e fundit, tregon besueshmëri për autoritetin. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit

të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë çdo dëshmi me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve dhe përvojën e tyre, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, përpiket të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës, po ashtu është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë kjo kategori e punonjësve. Vendosja e kriterit për një punësim të paktën **38 persona duke përfshirë dhe stafin teknik, është në**

përputhje me volumin e punës, natyrën, terrenin ku do të kryhen punimet si dhe grafikun e punimeve. Po t'i referohemi projektit, preventivit, relacionit, llogaritjeve përkatëse që ka bërë grupi i projektimit është plotësisht i justifikuar numri i punonjësve. Kriteri për kualifikim është vendosur që t'i shërbejë autoritetit për të njohur gjendjen e kapaciteteve të operatorëve të cilët nëpërmjet dokumentacionit të vërtetojnë se zotërojnë, kapacitetet teknike dhe profesionale, personelin e nevojshëm, si dhe kapacitetet organizative, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Analizat teknike janë bazuar në VKM nr. 629, datë 15.7.2015 "Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre" (Ndryshuar me VKM nr. 631, datë 26.10.2018). Bazuar në katër elementet e strukturës së kostos (material, puntori, makineri, transport) zeri fuqi puntore ze rreth 20% të kostos. Pra numri i stafit kryesor dhe mbështetës është llogaritur në baze të volumeve dhe grafikun e punimeve. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

2.3.7 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Lloji i Makinerive	Sasia
1. Kamion vetëshkarkues me masë maksimale të autorizuar (25-32) Ton	Copë 3
2. Kamionçinë vetëshkarkues me masë maksimale të autorizuar (3.5 – 7.5) Ton	Copë 1
3. Damper me zinxhira gome	Copë 2
4. Ekskavator me peshë jo më të vogël se 20 ton	Copë 2
5. Ekskavator me zinxhirë me peshë jo më të vogël se 25 ton	Copë 2
6. Traktor me zinxhire me peshe jo me te vogel se 10 ton	Copë 1
7. Fadrome me kove para dhe mbrapa me goma	Copë 1
8. Agregat hidraulik per pastrim vegjetacioni e bimesie d~10 cm (krah hidraulik decespugliator me peshe jo me pak se 150 kg)	Cope 1
9. Gjenerator me fuqi jo më pak se 5kW	Cope 1
10. Aparat Saldimi	Cope 1
11. Çekiç hidraulik per thyerje betoni (struktura ekzistuese)	Cope 1
12. Rul vibrues gomë-hekur me peshe jo me te vogel se 16 ton	Copë 1
13. Rul vibrues gomë-hekur me peshe jo me te vogel se 18 ton	Copë 2
14. Autobetoniere vetngarkuese me peshe jo me te vogel se 5.5 ton	Copë 2
15. Autobetoniere me peshe jo me te vogel se 20 ton	Copë 2
16. Autopompë betoni	Copë 2
17. Rimorkiator per transport mjetesh me kapacitet mbajtese jo me te vogel se 25 ton	Copë 1
18. Instrument Topografik (Stacion Total, GPS)	Copë 1
19. Automjet teknologjik për pastrimin e kolektoreve të bllokuar, e pajisur me bot me kapacitet bartës (9-12 ton), me ndarje membranë të lëvizshme (ndryshim volumi uje/material i ngurtë), e pajisur me pompë pastrimi me presion pune jo më pak se 170 bar, prurje jo me pak se 330 litra/minut dhe dy sonda me gjatesi me te madhe se 80m, e pajisur me pompe vakumi per thithjen e materialeve te ngurta me kapacitet jo me te vogel se 1500 m3/ore.	Copë 1
20. Automjet teknologjik për pastrimin e kolektorëve të bllokuar, e pajisur me bot me kapacitet bartes (2-4 ton), me ndarje membranë të lëvizshme (ndryshim volumi ujë/material i ngurtë), e pajisur me pompë pastrimi me presion pune, jo më pak se 200 bar, prurje jo më pak se 60 litra/minut dhe dy sonda me gjatësi më të madhe se 70 m, e pajisur me pompë vakumi për thithjen e materialeve të ngurta.	Copë 1
21. Automjet teknologjik për inspektimin e kolektorëve me diametër (250÷600) mm e pajisur me sisteme kamerash	Copë 1
22. Makine shpimi horizontale per instalim tubi me carje per zevendesim kolektoresh ekzistues Ø (250 ÷ 600), (Pipe bursting)	Copë 1
23. Makineri per ndertim mikrotunel D=110mm me lazer, per kalim tubi poshte rruges.	Copë 1

Për mjetet dhe pajisjet e sipërcituar të disponojë: Dëshmi, që ka në dispozicion apo mund t'i vihen në dispozicion sipas Kodit Rrugor operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës të shoqëruar me dokumentat si: Leja e qarkullimit, Çertifikata e Kontrollit Teknik, Çertifikata e Transportit të mallrave/Liçenca, Foto e mjetit (Për mjetet dhe pajisjet e tjera që nuk janë të shënuara në rregjistra publike duhet të disponojë dokumenta që vërtetojnë pronësinë/qiranë dhe librezat/te dhena teknike, ose ekuivalenti i tij/saj)

Ky kriter permbushet nepermjet paraqitjes se Formularit permbledhes te Vetedeklarimit sipas shtojces 8 ne DST

Argumetimi: Mjetet e mësipërme kërkohen: Duke u bazuar në proceset e punës, volumet e punimeve të preventivit dhe afatin e kryerjes se tyre.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Për të përcaktuar numrin e punonjësve dhe të mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, konkretisht sipas Vendimit nr. 629, datë 15.7.2015, “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre (ndryshuar me VKM nr. 631, datë 26.10.2018) dhe Udhëzimit nr.2, datë 08.05.2003, ”Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”.

Çdo mjet i përcaktuar sa më sipër është kerkuar ne funksion te kryerjes se zerave specifike te punimeve, ndërsa numri i mjeteve është përcaktuar ne varesi te volumeve te punimeve. percakton se ofertesit dhe rrjedhimisht fituesi i mundshem, vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën.

- 1. Kamion vetëshkarkues me masë maksimale të autorizuar (25-32) Ton (3 cope)**
Kerkohen kamionat pasi kemi volume punimesh si Transport dheu me auto ne vendeponizim te miratuar nga bashia, Mbushje me cakell e gur gurore ne trupin e rruges, Shtrese stabilizanti, etj...
- 2. Kamionçinë vetëshkarkues me masë maksimale të autorizuar (3.5 – 7.5) Ton (1 cope)**
Kerkohen pasi kemi volume punimesh si Transporti te materialeve te ndertimit ne kantier dhe jasht kantierit
- 3. Damper me zinxhira gome (2cope)** Kerkohen pasi kemi volume punimesh si Transport betoni dhe materiale te tjera brenda kantierit .
- 4. Ekskavator me zinxhirë me peshë jo më të vogël se 20 ton(2cope) , Ekskavator me zinxhirë me peshë jo më të vogël se 25 ton (2cope) ,Traktor me zinxhira me peshe jo me te vogel se 10 ton (1cope)**

Kerkohen pasi kemi volume punimesh si: Germim dheu me ekskavator, Ndertim kasonete ne toke mesatare, Mbushje me cakell e gur gurore ne trupin e rruges, perhapur e ngjeshur me makineri, Perforcim e rikonstruksion varreza ekzistuese ne zonat me rreshqitje aktive, etj...

- 5. Fadrome me kove para dhe mbrapa me goma (1 cope) .**
Kerkohen pasi kemi volume punimesh si: Mbushje me shtrese rere, Mbushje me zhavorr mbi tuba, mbas strukturave, etj...
- 6. Agregat hidraulik per pastrim vegjetacioni e bimesie d~10 cm (krah hidraulik decespugliator me peshe jo me pak se 150 kg) (1 cope) .**
Kerkohen pasi kemi volume punimesh shkulje rrenjeve bimeve.
- 7. Gjenerator me fuqi jo më pak se 5kW(1 cope) , Aparat Saldimi (1 cope) .**

Kerkohen pasi kemi volume punimesh si: F.V. Kangjella Dekorative + lyerje me dy dyar antiruxhio.

8. Cekic hidraulik per thyerje betoni (struktura ekzistuese) (1 cope) .

Kerkohen pasi kemi volume punimesh si: Prishje shtresa betoni.

9. Rul vibrues gomë-hekur me peshe jo me te vogel se 16 ton(1 cope), Rul vibrues gomë-hekur me peshe jo me te vogel se 18 ton (2cope).

Kerkohen pasi kemi volume punimesh si: Cilindrim kasonete me rul, Mbushje me cakell e gur gurore ne trupin e rruges, perhapur e ngjeshur me makineri.

10. Autobetoniere vetngarkuese me peshe jo me te vogel se 5.5 ton (2 cope).., Autobetoniere me peshe jo me te vogel se 20 ton(2 cope).., Autopompë betoni(2 cope)..

Kerkohen pasi kemi volume punimesh si: Ndertim rruge te brendshme me pllake betoni te parapergatitur t=6 cm beton, Ndertim rruge te brendshme me pllake betoni te parapergatitur t=6 cm beton. F.V. Beton C25/30 per mure, rrethim, puseta, portale, riparime strukturash ekzistuese, etj...

11. Rimorkiator per transport mjetes me kapacitet mbajtese jo me te vogel se 25 ton (1 cope) Kerkohen pasi do kete trasport te makinerive ne sheshin e ndetimit.

12. Instrument Topografik (Stacion Total, GPS) (1 cope)

Kerkohen pasi do behet piketimi i objektit dhe kontrolli i volumeve te punimeve.

13. Automjet teknologjik për pastrimin e kolektoreve të bllokuar, e pajisur me bot me kapacitet bartës (9-12 ton), me ndarje membranë të lëvizshme (ndryshim volumi uje/material i ngurtë), e pajisur me pompë pastrimi me presion pune jo më pak se 170 bar, prurje jo me pak se 330 litra/minut dhe dy sonda me gjatesi me te madhe se 80m, e pajisur me pompe vakumi per thithjen e materialeve te ngurta me kapacitet jo me te vogel se 1500 m3/ore. (1 cope), Automjet teknologjik për pastrimin e kolektorëve të bllokuar, e pajisur me bot me kapacitet bartes (2-4 ton), me ndarje membranë të lëvizshme (ndryshim volumi ujë/material i ngurtë), e pajisur me pompë pastrimi me presion pune, jo më pak se 200 bar, prurje jo më pak se 60 litra/minut dhe dy sonda me gjatësi më të madhe se 70 m, e pajisur me pompë vakumi për thithjen e materialeve të ngurta (1 cope).

Kerkohen pasi kemi volume punimesh si: Pastrim kolektori Ø (250 ÷ 600) me automjet teknologjik per pastrimin e kolektoreve.

14. Automjet teknologjik për inspektimin e kolektorëve me diametër (250÷600) mm e pajisur me sisteme kamerash (1 cope) .

Kerkohen pasi kemi volume punimesh si: Inspektim i kolektoreve Ø (250 ÷ 600) me automjet teknologjik i pajisur me sisteme kamerash.

15. Makine shpimi horizontale per instalim tubi me carje per zevendesim kolektoresh ekzistues Ø (250 ÷ 600), (Pipe bursting), Makineri per ndertim mikrotunel D=110mm me lazer, per kalim tubi poshte rruges (1 cope) .

Kerkohen pasi kemi volume punimesh si: Instalim tubi me carje per zevendesim kolektoresh ekzistues Ø (250 ÷ 600), (Pipe bursting).

2.3.8 Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikata

- Çertifikate per Sistemin e manaxhimit te cilesise (ISO 9001:2015) ose ekuivalente (e vlefsheme).

Sqarim:

Kjo çertifikatë mundëson që shoqëria të punojë me standarte e cilësi , e cila mundeson

implikimi në menaxhim, identifikimi i riskut dhe mundësive, sigurimi i konkurrencës

për personelin e shoqërisë, mirëmbajtja e pajisjeve dhe infrastrukturës, matja e kënaqësive të klientëve, përgjigje ndaj ankesave të marra dhe vlerësimi i furnitorëve, marrëdhënie biznesi me partnerët e njohur apo një imazh më të mirë në sytë e klientëve.

- Çertifikate për Sistemin e menaxhimit të mjedisit (ISO 14001:2015) ose ekuivalente (e vlefsheme).

Sqarim:

Kjo certifikatë mundëson që shoqëria të menaxhojë rreziqet mjedisore ekzistuese dhe potenciale. Ky sistem integrohet lehtësisht në strukturën e menaxhimit të biznesit për të kontrolluar impaktet që aktivitetet, operacionet, produktet dhe shërbimet kanë mbi mjedisin. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 14001:2015 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të identifikojë impaktin në mjedis gjatë aktivitetit të saj si dhe të përmirësojë performancën mjedisore duke zbatuar një qasje sistematike. Pra ky certifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ushtrojnë veprimtarinë duke pasur në konsideratë parimin e mbrojtjes së mjedisit.

- Çertifikate për Sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurimit në punë (OHSAS 45001:2018) ose ekuivalente (e vlefsheme).

Sqarim:

Sistemi i menaxhimit të sigurisë dhe shëndetit në vendet e punës mundëson që çdo kompani duhet të mbrojë shëndetin dhe sigurinë në punë për të gjithë punonjësit, e cila përfshin vlerësimin e rreziqeve të aksidenteve në punë, vendosjen e masave në fushën e shëndetit dhe sigurisë, inkurajimin e pjesëmarrjes së punonjësve në përpjekjet për të përmirësuar kushtet e punës, zbatimin e masave për të zvogëluar rreziqet e aksidenteve dhe sëmundjeve si dhe hetimin e incidenteve.

Certifikatat duhet të jenë të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

- Operatori ekonomik në konkurim duhet të jetë i pajisur me licencë nga Qendra Kombëtare e licensimit (QKL) Kodi III.2.B “Për grumbullim dhe transport i mbetjeve inerte”

Argumentimi: Duke qenese se për realizimin e punimeve do të gjenerohen mbetje inerte sipas zerave të preventivit:(Prishje shtresa betoni, Prishje mure, kanale, puseta e struktura betoni ekzistuese, Shkulje rrenjeve bimeve të vogla me eskavator, Germim dheu me ekskavator goma 0.15 m³, toke zak, kategoria III, me shkarkim në toke, Transport dheu me auto deri 5.0 km, etj.),

nevojitet qe OE te jete i licensuar per transportuar keto mbetje deri ne vendeponizimin e siguruar nga Njesia Vendore.

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, Ligjit Nr.10 081, datë 23.2.2009 “Për Licencat, Autorizimet dhe Lejet në Republikën e Shqipërisë”, Ligjit Nr. 10 463, datë 22.9. 2011 “Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve”

Argumentimi:

Kerkesat e mesiperme jane vendosur bazuar ne Nenin 79, pika 1 te Ligjit Nr. 162/2020, “Per prokurimin publik”, sipas të cilit: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe ne zbatim te Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”

2.3. 9 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

Kriteret për shpalljen e ofertës fituese

Bazuar në pikën 3, neni 45 Seksioni III VKM 285, datë 19.5.2021 PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE TË PROKURIMIT PUBLIK “Për punët/mallrat/shërbimet që kanë specifikime të thjeshta, standarde teknike të mirënjohura dhe janë lehtësisht të gjendura në treg, oferta ekonomikisht më e favorshme, bazohet **në çmimin si i vetmi element i ndryshueshëm ndërmjet ofertave**”

Specifikime teknike, projekti, preventivi, grafiku dhe kriteret kualifikuese u pasqyruan në DT, me të dhenat e mëposhteme:

1. Emri dhe adresa e Autoritetit/Entit Kontraktor

Emri Bashkia Durrës
Adresa Sheshi “Liria”, Qyteti Durrës
Tel/Faks 052 22 23 10
E-mail info@durres.gov.al
Ueb-faqe www.durres.gov.al

2. Lloji i procedurës së prokurimit: Procedurë e Hapur Punë

3. Numri i referencës së procedurës /Lotit: REF-59060-02-14-2023

4. Objekti i kontratës / Marrëveshjes Kuadër: “Rehabilitimi i zonës që preket nga zgjerimi territorial i varrezave të qytetit të Durrësit”

5. Kodi sipas Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit (FPP): Kodi CPV: 45112714-3 - Punime në natyrë për varreza

6. Fondi limit: 240’000’000 (dyqind e dyzetë milion) lekë pa TVSH.

7. Kohëzgjatja e kontratës/marrëveshjes kuadër ose afati për zbatimin e saj: 720 ditë

8. Afati i fundit për paraqitjen dhe hapjen e ofertave: 02.03.2023 Ora 10.00

Dokumentat e tenderit me kërkesat si më sipër firmosen nga anëtarët e njësisë së prokurimit, pas miratimit të gjithë anëtarëve të njësisë kanë akses (autorizohen) për botimin e tyre në rrugë elektronike pranë APP(www.app.gov.al).

Njësia e Prokurimit